

PROPOZIME NË LIDHJE ME PROJEKT LIGJIN
“Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”

Drejtuar: Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Nga: Trupa e Oficerëve të Seksionit të Policisë Gjyqësore, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Të nderuar anëtarë të komisionit!

Nga studimi i këtij projektligji të bërë nga ana jonë, rezulton se në tërësinë e tij ai paraqet disa problematika në hartimin e tij dhe për këtë arsye po ju paraqesim disa propozime në lidhje me nenet konkrete.

Këto propozime të cilat parashtrojmë më poshtë, kërkojmë gjithashtu të diskutohen me debat të hapur me Anëtarët e Komisionit të Ligjeve dhe kryesisht relatorit të këtij projektligji Z. Ulsi Manja.

Neni 2. Lidhur me titullin e nenit 2, të ndryshohet termi nga “Përcaktime” në “Përkufizime”.
Në gërmën “a”, të këtij neni është përcaktuar se: “Funksioni i policisë gjyqësore” është cilësia që u jepet me ligj punonjësve të Policisë së Shtetit, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe organeve të administratës publike...”. Mendojmë se pas shprehjes “Byrosë kombëtare të hetimit” të shtohet edhe termi “Seksioni i Policisë Gjyqësore”.

Në gërmën “b” pas fjalës person të hiqen fjalët “i caktuar, ose”.

Në gërmën “c” është përdorur termi “Hetues” për punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit të cilët kanë statusin e Oficerëve të Policisë Gjyqësore, ndërsa Oficerët e Seksioneve pranë Prokurorisë, do të quhen *thjesht* “Oficerë të Policisë Gjyqësore”. Shtrohet pyetja, a mundet që brenda një strukture të përdoren dy terma, edhe “Hetues” edhe “Oficer i Policisë Gjyqësore”, kur veprimtaria e tyre është e njëjtë, pra është hetimi i veprave penale nga ana e tyre, të bazuara mbi përcaktimet dhe detyrat që njeh Kodi i Procedurës Penale.

Të shikohet mundësia që i gjithë personeli i strukturave që kanë në funksion e tyre hetimin e veprave penale (Seksionet e Policisë Gjyqësore pranë çdo Prokurorie), të njësohet emërtimi i tyre.

Neni 3. Në pikën 1, shprehja “... **që sigurojnë kushtet për ushtrimin e ndjekjes penale**”, është e pakuptimtë, pasi policia gjyqësore duhet që të udhëhiqet dhe të zbatojë parimet e përcaktuara në nenin 3, gjatë gjithë ushtrimit të funksioneve dhe veprimtarisë së saj. Kjo pikë mund të riformulohet: “**Policia gjyqësore, gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë, objektivitetit, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe zbulimit të së vërtetës**”.

Neni 4. Konkretisht në titullin e tij ky nen bën fjalë për parimet e veprimtarisë së policisë

gjqësore, ndërsa në brendësi të saj përdoret termi “**administrata e policisë gjyqësore rregullohet me ligj**”. Çfarë do të kuptojmë me këtë term? A është ky ligji i cili rregullon të gjithë veprimtarinë e policisë gjyqësore?

Propozojmë që fjala “Administrata” të zëvendësohet me shprehjen “Veprimtaria e Policisë Gjyqësore”.

Gjithashtu pika 1 është përsëritje e nenit 3/1, pasi të dyja këto nene bëjnë fjalë për parimet nga të cilat duhet të udhëhiqet veprimtaria e policisë gjyqësore, pra pika 1 e nenit 3 duhet hequr, duke u parashikuar në nenin 4, dhe titulli i nenit 3 të bëhet “**Funksionet e Policisë Gjyqësore**”.

Pika 2 që bën fjalë për statusin e oficerëve të policisë gjyqësore, duhet të parashikohet si në mënyrë të veçantë, ku të parashikohen edhe të drejtat dhe detyrimet e oficerit të policisë gjyqësore, ku të përcaktohet edhe paga e oficerit të Policisë Gjyqësore, e cila në minimumin tonë të jetë **jo më pak se 70 %** e pagës së prokurorit të prokurorisë ku ushtrohet funksioni. (kjo referuar edhe ligjit të mëparshëm për Policinë Gjyqësore).

Gjithashtu sugjerojmë të rregullohet përllogaritja e vjetërsisë në punë për çdo vit vjetërsi: konkretisht, për çdo vit vjetërsi, pages t’i shtohet 2 për qind në vit deri në 25 vjet shërbim dhe vjetërsia të llogaritet pas 5 vitesh pune. (*Parashikuar në ligjin ekzistues*).

Neni 5. Në pikën 4 është përcaktuar se : “**Oficerët e policisë gjyqësore sipas paragrafeve 2 dhe 3, që zotërojnë përvojën dhe arsimin e duhur, mund të vlerësohen për t’u pranuar në shërbimet e policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, në përputhje me ligjin në fuqi**”.

Mendojmë që kjo pike të hiqet pasi kriteret për t’u emëruar pranë BKH –së, janë përcaktuar në ligjin përkatës të kësaj structure të re.

Neni 6. Të hiqet shprehja “**ligji për nënpunësin civil**” dhe paga të vendoset sipas kërkesës sonë prej jo më pak se 70% e pagës së Prokurorit. (Siç kërkuar në ndryshimet për nenin 4).

Gjithashtu të hiqet fjala “**Punonjësit**” dhe të zëvendësohet me shprehjen “**Oficerët e Policisë Gjyqësore**”.

Neni 10. Pas fjalës “**Byroja Kombëtare e Hetimit**”, të shtohet edhe fjala “**Oficerët e Policisë Gjyqësore të Seksioneve të Prokurorisë**”.

Neni 12. Në lidhje me pikën 1, duhet të hiqet termi rekrutim dhe të zëvendësohet me fjalën “përzgjedhje”.

Cila do të jetë detyra më e ulët dhe më e lartë që mund të kryejë oficeri i policisë gjyqësore në seksionin e prokurorisë?

A parashikohet ecuri karriere për ngritje në detyrë për Oficerët e Policisë Gjyqësore të Seksioneve? (*Kjo pasi në ligjin e vjetër të Prokurisë i shfuqizuar tashmë, parashikohej që një përqindje e Prokurorëve të përzgjidheshin nga radhët e Oficerëve të Policisë Gjyqësore, duke ju nënshtruar një konkurimi midis tyre, të hapur dhe transparent*)

A do kishte stimul personal për secilin prej tyre dhe synime për zhvillimin dhe përmirsimin e performacës në punë, me qëllim zhvillimin e ambicies për t’u emëruar Prokuror?

Sugjerojmë që në ligj të përcaktohet qartë se të gjitha lëvizjet duke filluar nga emërimi, transferimi apo edhe largimi nga funksioni në Seksionet e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë, të cilitdo nivel, të jetë kompetencë ekskluzive e KLP –së.

Gjithashtu propozojmë që në ligj të përcaktohet që në lidhje me ngritjen në karrierë të Oficerëve të Policisë Gjyqësore të Seksioneve të Prokurorisë, të cilët kanë arsimin juridik, diplomë e nivelit të Dytë (*DND*) ose të sistemit të vjetër 4 – vjeçar si dhe një eksperiencë në ushtrimin e funksionit të OPGJ –së të Seksionit të Prokurorisë për një periudhë jo më pak se 5 vjet, ka të drejtë të konkurojë dhe të jetë kandidat për Prokuror pranë KLP –së *(ku kjo e fundit mbi bazën e vlerësimit të punës, CV-së, natyrës së hetimeve të kryera përgjatë karrierës si OPGJ i Seksionit të Prokurorisë, pastërtisë së figurës dhe mungesës së masave disiplinore, vlerësojnë me shumicë vote kandidatën apo kandidatët e vlefshëm dhe që plotësojnë kriteret në fjalë, për t’ju bashkuar vitit shkollor pranë Shkollës së Magjistraturës)*, pa konkurim të përgjithshëm drejtpërdrejt në Shkollën e Magjistraturës. Përsa i përket përqindjes së pranimi, t’i referohen numrit të vendeve për Prokuror që shpall Shkolla e Magjistraturës në vitin përkatës. (normalisht, për zbatimin e kësaj pike, në rast vendosjeje në këtë ligj të këtij përcaktimi, duhet harmonizuar me Ligjin Mbi Shkollën e Magjistraturës ku të vendoset në kriteret e pranimi edhe përqindja e OPGJ –ve që do vinë nga përzgjedhja e KLP –së).

Në lidhje me pikën 2, mendojmë që drejtuesi i komisionit të jetë prokuror dhe të gjithë antaret e tjerë të jenë OPGJ (hetues).

Neni 13. Të përcaktohet në ligj se nga cila strukturë do të zgjidhet Drejtori i Policisë Gjyqësore.

Ka ndërthurje të kompetencave që ka Komisioni i Policisë Gjyqësore me Drejtorin e Policisë Gjyqësore? (Sipas këtij projektligji, kompetencat janë të njëjta).

Neni 14. Të shtohet shprehja “Funksionet e policisë gjyqësore ushtrohen edhe nga Seksionet e Policisë Gjyqësore në Prokurori”.

Neni.15 Të hiqet pika 1, pasi është përsëritje e pikës “2” të nenit 14.

Neni 18 Të hiqet shprehja “ulje në detyrë”, pasi kjo masë nuk mund të jetë e zbatueshme për oficerin e policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë. Gjithashtu transferimi, pezullimi dhe shkarkimi i oficerit të policisë gjyqësore duhet të bëhen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe jo nga Komisioni i Policisë Gjyqësore.

Fjala “**rekrutohen**” të zëvendësohet me fjalën “**përzgjedhja**”.

Neni 20 Titulli i këtij neni nga “Zyrat e shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë Policisë së Shtetit” duhet ndryshuar duke u bërë “**Zyrat e shërbimeve të policisë gjyqësore**”. Ky ligj rregullon veprimtarinë e policisë gjyqësore në tërësi dhe jo vetëm të Policisë së Shtetit (*kjo e fundit rregullohet me ligj të veçantë*).

Neni 24. Procedura e konkurrimit dhe përzgjedhja e fituesve duhet të rregullohen me vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe jo të Komisionit të Policisë Gjyqësore.

Neni 25 Ky kriter mendojme se duhet të jetë persa i përket personave që fillojnë punë për herë të parë pranë seksionit të prokurorisë si edhe për OPGJ -te që vijnë nga radhët e administratës publike.

Kërkojmë të vendoset taksativisht kriteri që Oficeri o Policisë Gjyqësore i Seksionit të Prokurorisë (pra kandidaturat për të qenë pjesë e këtij seksioni) të kenë arsim të lartë juridik, përveç kriterve të tjera të parashikuara në këtë nen.

Neni 30 Në pikën 2 është përcaktuar se drejtuesi i grupit hetimor caktohet oficeri i policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit. Një përcaktim i tillë duhet hequr pasi grupi hetimor drejtohet dhe kontrollohet nga prokurori dhe ai është autoriteti i cili cakton drejtuesin e grupit hetimor. (kjo është e përcaktuar qartë në Kodin e Procedurës Penale).

Neni 42 Në lidhje me pikën 1, sugjerojmë që kursi bazë dhe i avancuar për teknikat e hetimit të zbatohet vetëm për ata persona që ushtrojnë funksionin e policisë gjyqësore në seksionin e prokurorisë dhe kanë një përvojë pune deri në 5 vjet, si dhe personat që përzgjidhen nga administrata publike për herë të parë

Në përfundim mendojmë se ky ligj duhet riparë edhe njëherë duke ngritur një grup pune nga të gjitha strukturat edhe shërbimet policore apo të administratës publike, të cilëve ligji u njeh të drejtën që të kryejnë hetime.

Gjithashtu ligji duhet harmonizuar edhe me ndryshimet që priten të bëhen në projekt ligjin **“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.7905, datë 21.03.1995 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”**, pasi nuk ka një harmonizim midis tyre përsa i përket neneve që i përkasin Policisë Gjyqësore.